2015	17.103	15.612	1,10	677

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile  
Source: INSTAT, Albanian Civil Office

\* Ky tregues është llogaritur nëse raporti gjinor në lindje do të ishte 1,05  
\* This indicator is calculated if the sex ratio at birth it would be 1.05

## Raporti gjinor në lindje

Sex ratio at birth



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

## Raporti gjinor sipas rradhës së lindjes, 2015

Sex ratio by birthorder of births, 2015

Rradha e lindjes Birthorder	Meshkuj Men	Femra Women	Raporti gjinor Sex ratio
1	7.519	7.047	106,7
2	5.593	5.144	108,7
3	2.043	1.746	117,0
4+	669	531	126,0
Mungojnë Missing	1.618	1.518	106,6

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile  
Source: INSTAT, Albanian Civil Office

## Lejet e lindjeve dhe lindjet sipas zonave urbane dhe rurale


Maternity leave and birth by urban and rural areas

Vitet Years	Urbane-Urban		Rurale-Rural	
	Leje lindje Maternity leave	Lindje Live birth	Leje lindje Maternity leave	Lindje Live birth
2012	6.954	13.260	4.681	22.245
2013	6.703	13.019	4.805	22.421
2014	7.594	12.919	4.348	22.841
2015	7.501	17.422	4.901	15.169

Burimi: INSTAT, Instituti i Sigurimeve Shoqërore  
Source: INSTAT, Social Insurance Institute

## Raporti i lejeve të lindjeve me lindjet sipas zonave urbane dhe rurale

Maternity leave ratio with birth by urban and rural areas



Burimi: INSTAT, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Source: INSTAT, Social Insurance Institute

## Koeficientët specifikë të lindshmërisë sipas grupmoshës së nënës dhe Indeksi Sintetik i Fekonditetit

Age group specific fertility rate and Total Fertility Rate

Vitet Years	Lindje Live births	Koeficienti specifik i lindshmërisë sipas grupmoshës për 1,000 femra							ISF* TFR*	KBR** GRR**	Mosha mesatare në lindje Mean age at birth
		Age group specific fertility rate per 1,000 women									
		15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49			
<b>2006</b>	35.891	17,7	94,2	126,3	68,4	23,0	4,4	0,5	1,67	0,78	27,5
<b>2007</b>	34.448	17,4	91,6	119,7	67,4	22,6	4,0	0,6	1,62	0,76	27,5
<b>2008</b>	33.445	18,4	87,3	115,0	64,6	24,6	5,0	1,5	1,58	0,74	27,7
<b>2009</b>	34.114	19,0	91,5	120,3	66,5	22,9	4,5	0,8	1,63	0,77	27,5
<b>2010</b>	34.061	20,6	92,5	114,7	69,6	24,7	4,1	0,5	1,63	0,77	27,5
<b>2011</b>	34.285	21,0	95,7	117,5	68,2	23,6	3,7	0,4	1,65	0,79	27,4
<b>2012</b>	35.473	20,9	105,4	119,4	69,6	23,8	4,2	0,5	1,72	0,82	27,3
<b>2013</b>	35.750	20,4	108,2	124,0	69,2	25,3	4,3	0,5	1,76	0,84	27,3
<b>2014</b>	35.760	21,7	109,3	125,9	69,7	25,2	4,4	0,3	1,78	0,85	27,2
<b>2015</b>	32.715	20,2	102,5	119,2	64,0	24,0	3,4	0,4	1,67	0,80	26,7

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile


Source: INSTAT, Albanian Civil Office

\*Indeksi Sintetik i Fekonditetit - Total Fertility Rate

\*\*Koeficienti bruto i riprodhimit - Gross Reproduction Rate

### Koeficientët specifikë të lindshmërisë sipas grupmoshës


Age group specific fertility rate



Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile  
 Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office  
 \*Indeksi Sintetik i Fekonditetit - Total Fertility Rate

### Indeksi sintetik i fekonditetit, 2006-2015

Total Fertility rate, 2006-2015



Burimi: INSTAT  
 Source: INSTAT

### Lindjet dhe abortet


Live births and abortions

Vitet	Lindje	Aborte	Raporti i abortit	Lidhja: Lindje/ Aborte
Years	Live births	Abortions	Abortion rate	The Relation: Births/Abortions
2006	35.891	9.552	266	3,8:1
2007	34.448	9.030	262	3,8:1
2008	33.445	8.335	249	4,0:1
2009	34.114	9.200	270	3,7:1
2010	34.061	8.085	237	4,2:1
2011	34.285	8.307	242	4,1:1
2012	35.473	7.846	221	4,5:1
2013	35.750	6.638	186	5,4:1
2014	35.760	5.572	156	6,4:1
2015	32.715	5.619	172	5,8:1

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), Ministria e Shëndetësisë  
Source: INSTAT, Albanian Civil Office, Institute of Public Health (IPH), Ministry of Health


### Raporti i abortit

Abortion rate



**Lidhja: Lindje/ Aborte**

The Relation: Births/Abortions



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

**Vdekjet sipas gjinisë**

Deaths by sex

Vitet	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Years	Men	Women	Total
2006	11.349	9.503	20.852
2007	11.616	9.270	20.886
2008	11.610	9.139	20.749
2009	11.255	9.173	20.428
2010	10.906	9.201	20.107
2011	10.854	9.158	20.012
2012	11.170	9.700	20.870
2013	10.990	9.452	20.442
2014	11.111	9.545	20.656
2015	11.837	10.581	22.418

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile  
Source: INSTAT, Albanian Civil Office




### Vdekjet nën 1 vjeç sipas gjinisë

Infant deaths by sex

Vitet Years	Meshkuj Men	Femra Women	Gjithsej Total
2006	262	204	466
2007	229	182	411
2008	205	167	372
2009	194	158	352
2010	181	147	328
2011	165	134	299
2012	176	136	312
2013	171	111	282
2014	145	136	281
2015	134	99	233

### Vdekshmëria foshnjore për 1000 lindje


Infant deaths per 1000 live births



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

### Vdekshmëria sipas grupmohave dhe gjinisë, 2015


Deaths by age group and sex, 2015



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

### Jetëgjatësia mesatare në lindje, 2006-2015

Average life expectancy at birth, 2006-2015



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

### Shpeshtësia e SST-ve, HIV/AIDS-it sipas viteve dhe gjinisë

Incidence of SST & HIV/AIDS by years and sex


Vitet Years	Numër-Number		%	
	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Gjithsej Total
2013	83	41	67	33
2014	63	21	75	25
2015	74	29	72	28

Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Source: Institute of Public Health

### Shpeshtësia e SST-ve, HIV/AIDS-it sipas viteve dhe gjinisë

Incidence of SST & HIV/AIDS by years and sex



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Source: Institute of Public Health

**Martestat sipas gjinisë dhe grupmoshës**


Marriages by sex and age group

Grup moshë	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Age group
<b>Nuset - Bride</b>											
<b>Gjithsej</b>	<b>21.332</b>	<b>22.371</b>	<b>21.290</b>	<b>26.174</b>	<b>25.428</b>	<b>25.556</b>	<b>22.891</b>	<b>23.820</b>	<b>23.769</b>	<b>24.997</b>	<b>Total</b>
Deri 19	5.333	6.383	5.945	7.022	6.328	5.708	5.718	5.632	5.319	5.342	Up to 19
20 - 24	10.276	10.194	9.406	11.426	11.178	11.479	9.600	10.043	9.917	10.407	20 - 24
25 - 29	3.749	3.833	3.773	5.120	5.234	5.532	4.999	5.275	5.413	5.842	25 - 29
30 - 34	1.169	1.103	1.140	1.533	1.659	1.736	1.563	1.709	1.855	2.009	30 - 34
35 - 39	466	476	464	600	563	608	536	643	712	746	35 - 39
40 - 44	185	212	190	246	227	278	255	249	276	345	40 - 44
45 - 49	95	110	106	127	128	110	115	125	147	164	45 - 49
Mbi 50	59	60	16	100	111	105	105	144	130	142	Over 50
Të panjohur	0	0	250	0	0	0	0	0	0	0	Unknown
<b>Dhëndurët - Bridegroom</b>											
<b>Gjithsej</b>	<b>21.332</b>	<b>22.371</b>	<b>21.290</b>	<b>26.174</b>	<b>25.428</b>	<b>25.556</b>	<b>22.891</b>	<b>23.820</b>	<b>23.769</b>	<b>24.997</b>	<b>Total</b>
Deri 19	237	257	237	121	145	153	190	154	139	169	Up to 19
20 - 24	4.468	4.716	4.308	4.732	4.614	4.484	4.253	4.204	4.022	4.241	20 - 24
25 - 29	9.609	10.147	9.381	11.672	11.207	11.236	10.034	10.358	10.128	10.466	25 - 29
30 - 34	4.522	4.648	4.533	5.988	5.973	6.070	5.140	5.727	5.833	6.273	30 - 34
35 - 39	1.452	1.540	1.471	2.078	1.978	2.070	1.858	1.903	2.063	2.108	35 - 39
40 - 44	531	509	538	801	761	817	729	748	793	843	40 - 44
45 - 49	249	272	265	385	354	345	317	313	360	434	45 - 49
Mbi 50	264	282	31	397	396	381	370	413	431	463	Over 50
Të panjohur	0	0	526	0	0	0	0	0	0	0	Unknown

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile  
 Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

### Përçindja e martesave sipas grupmoshave dhe gjinisë, 2015


Percentage of marriages by age group and sex, 2015



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

### Normat e martesave sipas grupmoshës së femrave


Marriage rates by age group of women



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

## Mosha mesatare e martesës sipas gjinisë

Mean age of marriage by sex



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

## Martestat dhe divorcet


Marriages and divorces

Vitet Years	Martestat-Marriages		Divorcet-Divorces	
	Gjithsej	Koeficienti bruto i martesës	Gjithsej	Koeficienti i divorcit
	Total	Gross Rate of marriage	Total	Coefficient of divorce
2006	21.332	7,1	4075	19,1
2007	22.371	7,5	3305	14,8
2008	21.290	7,2	3610	17,0
2009	26.174	8,9	3606	13,8
2010	25.428	8,7	3478	13,7
2011	25.556	8,8	3642	14,3
2012	22.891	7,9	3561	15,6
2013	23.820	8,2	3747	15,7
2014	23.769	8,2	4240	17,8
2015	24.997	8,7	5255	21,0

Burimi i informacionit: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile, Ministria e Drejtësisë  
Source of information: INSTAT, Albanian Civil Office, Ministry of Justice

### Koeficienti i divorcit sipas viteve 2006-2015

Coefficient of divorce by year 2006-2015



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

## Arsimi

Statistikat e arsimit japin të dhëna për aktivitetin e institucioneve përkatëse në lidhje me kryerjen e arsimit zyrtar në vend. Në këtë botim trajtohen në mënyrë më të veçantë të dhënat për nxënës, studentë dhe stafin mësimdhënës, sipas gjinisë dhe niveleve të arsimit.

Vërehet se niveli i njohurive të fituar nga shkollat vjen në rritje të vazhdueshme sasiore dhe cilësore. Kjo ka të bëjë me pasurimin e kurrikulave në të gjitha nivelet e arsimit, por edhe me rritjen e pjesëmarrjes në arsim. Pjesëmarrja e të rinjve në arsimin e lartë është e lartë. Gjithashtu nuk përbën më risi fakti që pjesën më të madhe ndër studentët e regjistruar e zënë femrat, të cilat në vitin 2014/15 përbëjnë përsëri 57 % e totalit të tyre.

Numri i të diplomuarëve në arsimin e lartë në vitin 2015 është rritur akoma më tepër krahasuar me vitet e mëparëshme. Vazhdon të ngelet i lartë edhe për vitin 2015 raporti i femrave të diplomuara me 64 % krahasuar me 36 % të meshkujve. Peshën kryesore në diplomat e marra sipas fushave të studimit në arsimin e lartë, e zë ajo e shkencave të biznesit, administrimit dhe ligjit me 29 % të gjithë të diplomuarve, e cila varion në raport femra me meshkuj prej 59 dhe 41 %.

Krahasimi ndërmjet fushave të studimit, më e dominuar nga femrat e diplomuara është fusha e shkencave të arsimit, e ndjekur nga ajo e shëndetit dhe mirëqënies, e më pas në ndryshim nga vitet e mëparëshme nga ajo e shkencave natyrore, përkatësisht 80, 76 dhe 73 %. Ndërsa fusha më e dominuar nga meshkujt në arsim e lartë është ajo shërbimeve, pasuar nga ajo e e inxhinierive, e më tej ajo e bujqësisë dhe teknologjise së informacionit, përkatësisht 63, 58, 55 dhe 51 %.

Në vitin 2014/15 ka një rritje të numrit të nxënësve që marrin diplomë të arsimit të mesëm krahasuar me vitin paraardhës. Gjatë këtij viti rezultojnë të kenë marrë dëftesë pjekurie 51,4 % femra dhe 48,6 % meshkuj; 88 % nxënës në gjimnaz dhe 12 % nxënës në arsimin profesional. Përqindja e djemeve që përfunduan arsimin e detyruar është 51,4 % kundrejt 48,6 % vajza.

## Education

Education statistics provide data about the activity of respective education institutions regarding official education in the country. This publication specifically addresses data about students, and teaching staff according to gender and educational attainment.

There is an increasing trend toward qualitative and quantitative knowledge in education. This is aimed at enriching the curricula in all levels of education but also at increasing participation in education. Youth participation in tertiary education is high. It is not new that the majority of enrolled students are females. During the academic year 2014/15 females again accounted for 57% of all students.

The number of student graduates for 2015 has increased compared to previous years. Likewise, the ratio of female graduates to male graduates for 2015 is higher, 64% females compared to 36 % males. The main areas of study, as measured by numbers of graduating students from tertiary education, are: business science, administration, and law, accounting for 29% of all graduates, with 59% of them being female and 41% male.

Looking at which subject areas have the greatest percentage of female graduates, Education Science, then Health and Welfare and in a change from previous years, Natural Science have females in the following percentages: 80, 76 and 73%. The subject areas with the highest percentage of male graduates are services, engineering, agriculture, and IT, at respectively 63, 58, 55 and 51%.

For the academic year 2014/15 there was an increase in the number of graduates of upper secondary education, compared to the previous year. Graduates from State Matura were 51.4% female and 48.6 % male; 88% completed general secondary education and 12% vocational education.



Struktura e stafit akademik sipas gjinisë në universitete ka rritje graduale në vlerë absolute për femrat. Në dallim nga vitet e mëparëshme vitin e fundit akademik 2014/15 janë rritur sidomos femrat me titullin Professore në 36 % nga 31 % që ishin në vitin 2013/14. Ndërsa përsa i përket stafit me Doktoraturë struktura është 46% për meshkujt dhe 54% për femrat. Stafi më pak i kualifikuar janë Docentët dhe Pedagogë pa tituj është gjithnjë e më tepër femra, i cili në vitin e fundit arrin 61 %.


Mësueset femra përbëjnë mbi 65 % në arsimin e mesëm dhe 73 % në arsimin 9 vjeçar.

Of those who completed compulsory education, 51.4% were boys versus 48.6% for girls. The figures from recent years point to a gradual increase of females in absolute terms, even though the figures for males are still high. But, in a change from previous years (2014/15), there have been an increasing number of women Professors to 36% as compared to 31% which was the figure for the academic year 2013/14. Doctorate degree figures are 46% for males and 54% for females. The lesser qualified staff are Docents and university lecturers and those are increasingly female, and this figure in the last academic year is 61%.

Female teachers in upper secondary education account for over 65%, and in compulsory education they account for 73%.

**Fëmijë në kopshte në (%)**


Children in kindergarten in % (NER)



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

**Niveli i pjesëmarrjes në arsimin e lartë/rapoti i regjistrimit bruto**

Participation level in tertiary /gross enrolment ratio (GER)



Burimi: INSTAT  
Source: INSTAT

**Nxënës në shkolla sipas programit dhe gjinisë (2010-2015)**

Pupil in schools by programmes and sex (2010-2015)

Në/In (%)

Programi	2010-11		2013-14		2014-15		Programme
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Men	Women	Men	Women	Men	Women	
Mesme	54	46	54	46	54	46	Upper secondary
Cikli i lartë i 9 vjeçares	52	48	53	47	53	47	Lower secondary
Fillore	53	47	53	47	52	48	Primary

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

**Studentë të diplomuar në numër dhe sipas gjinisë**

Graduated students Number and sex distribution

Vitet Years	Numër - Number		Sipas gjinisë/Sex distribution	
	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women
<b>2009-10</b>	7.943	14.415	35,5	64,5
<b>2010-11</b>	8.301	14.513	36,4	63,6
<b>2011-12</b>	10.383	18.728	35,7	64,3
<b>2012-13</b>	10.641	19.724	35,0	65,0
<b>2013-14</b>	9.963	19.174	34,2	65,8
<b>2014-15</b>	11.960	21.569	36,0	64,0

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

## Nxënës që mbaruan dhe u diplomuan

Pupils graduated

Nxënës	2009 - 10	2010 - 11	2011 - 12	2012 - 13	2013-14	2014-15	Pupils
<b>Nxënës që morën dëftesë</b>	52.287	51.186	50.380	47.819	44.139	44.001	<b>Pupils graduated on basic education</b>
Meshkuj	26.453	26.031	25.801	24.655	22.845	22.610	Men
Femra	25.834	25.155	24.579	23.164	21.294	21.391	Women
<b>Nxënës morën Çertifikata në arsimin profesional</b>	1.433	1.517	4.222	-	5.691	5.672	<b>Pupils Certified on secondary technical</b>
Meshkuj	1.351	1.431	3.795	-	4.910	4.918	Men
Femra	82	86	427	-	781	754	Women
<b>Nxënës që morën dëftesë pjekurie arsimit mesem</b>	34.823	40.354	40.927	45.899	35.254	39.629	<b>Pupils graduated on upper secondary education</b>
Meshkuj	16.096	20.260	20.126	23.274	16.372	19.249	Men
Femra	18.727	20.094	20.801	22.625	18.882	20.380	Women
<b>Diplomuar pas të mesme</b>	114	232	242	145	164	125	<b>Graduated on post</b>
Meshkuj	68	146	125	79	64	75	Men
Femra	46	86	117	66	100	50	Women

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

## Mësuesit në arsimin 9 vjeçar dhe të mesëm në (%)

Teachers of preuniversity education in (%)

Vitet Years	Në 9 vjeçare - Basic education		Në të mesme - Upper secondary	
	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women
2009-10	30	70	38	62
2010-11	28	72	38	62
2011-12	28	72	38	62
2012-13	27	73	36	64
2013-14	27	73	36	64
2014-15	27	73	35	65

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

## Trupi mësuesor shkencor efektiv në arsimin e lartë, sipas titujve e gradave në (%)

Academic Effective staff in Tertiary education by titles and grades in (%)


Viti Akademik Academic Year	Profesorë Professors		Doktorë Phd		Docentë dhe Pedagogë pa tituj Docents and Pedagogues without titles	
	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women
2010-11	73	27	44	56	43	57
2011-12	74	26	52	48	40	60
2012-13	71	29	53	47	38	62
2013-14	69	31	49	51	38	62
2014-15	64	36	46	54	39	61

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

### Studentët e diplomuar në arsimin e lartë sipas fushave të studimit, 2015

Students graduated on tertiary by field of study, 2015



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Shënim: Sipas Manualit të Fushave të Studimit 2013

Note: ISCED Fields of Education and Training 2013 (ISCED-F 2013)

### Niveli arsimor i popullsisë në (%)

Educational attainment of population in (%)

Popullsia 25 +	Grupmoshat-Age group								Population 25 +
	25-39		40-64		65 +		Total		
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Men	Women	Men	Women	Men	Women	Men	Women	
Me arsim fillor dhe 8/9 vjeçar	43,8	47,9	42,2	52,0	64,2	81,0	46,8	56,6	Primary and Lower secondary
Me arsim të mesëm	35,8	23,4	44,9	36,6	23,0	15,2	38,2	28,8	By upper Secondary
Me arsim të lartë	20,4	28,6	12,9	11,4	12,8	3,8	15,0	14,7	By tertiary
<b>Gjithsej</b>	100	100	100	100	100	100	100	100	<b>Total</b>

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2015

Source: Labour Force Survey, 2015

### Stafi Universitar sipas gjinisë, 2015-16

University staff by sex, 2015-16

Posti	Numër-Number		%		Position
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Men	Women	Men	Women	
Rektor	12	0	100	8	Rector
Zv/Rektor	14	7	67	39	Deputy Rector
Anëtarë Senati	177	80	69	33	Member of Senate
Dekanë	40	13	75	25	Dean
Zv/Dekan	43	27	61	41	Deputy Dean
Anëtarë të Këshillit të Fakultetit	401	257	61	45	Member Faculty's Council
Përgjegjës Departamenti	145	84	63	38	Chef of department.
Anëtarë i Zgjedhur i Këshillit të Departamentit	225	273	45	56	Member of Department's Council


Burimi: Rektoratet e Universiteteve Publike

Source: Rectorates of Public University

Shënim: Për vitin 2015 të dhënat e datajuara të stafit i referohen Universiteteve Publike.

Note: Data for year 2015 refers personnel only in public University.

**Përqindja e studentëve me aftësi të kufizuar sipas gjinisë në Universitete Publike, 2015-16**  
 Percentage of students with disabilities by sex in Public Universities, 2015-16



Burimi: Rektoratet e Universiteteve Publike

Source: Rectorates of Public University

Shënim: Për vitin 2015 të dhënat e datajuara i referohen Universiteteve Publike.

Note: Data for year 2015 refers only in public University.





## Statistikat juridike

Statistikat juridike të paraqitura në këtë kapitull na japin një pasqyrë të të dhënave të disagreguara sipas gjinisë për të dhënat mbi krimet (autorë dhe të dëmtuar), të dënuarit si dhe të burgosurit sipas disa karakteristikave sociale, informacione këto të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe nga Ministria e Drejtësisë. Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale dhe jo në gjykimet, të cilat mbeten kompetencë e organeve të drejtësisë për të dhënë vendimin e formës së prerë.

Të dhënat mbi të burgosurit ilustronin statistikën lidhur me numrin e të burgosurve sipas gjinisë, nivelit arsimor të ndjekur, grupmoshës, veprave penale për të cilat janë dënuar si dhe rreth kurseve të formimit profesional që ndjekin në burgje, të dhëna këto që përfshijnë si të paraburgosurit dhe të dënuarit me burg deri më 31 Dhjetor të çdo viti. Në vitin 2015 numërohen 6.128 të burgosur, nga të cilët 6.011 janë meshkuj dhe 117 femra. Grupmoshat që dominojnë në burgje si për femrat dhe meshkujt janë 30-60 vjeç ndjekur nga grupmosha 18-30. Ndërsa vite numrin më të madh të burgosurve si femra dhe meshkuj i kemi me arsim 9 vjeçar, ndjekur më pas nga personat me arsim të mesëm. Për vitin 2015, në totalin e gjithë meshkujve të burgosur, %jen më të lartë të tyre e zënë ata me arsim 9 vjeçar, ndërkohë arsimi i mesëm ka përafërsisht të njëjtën %je si për meshkujt, ashtu edhe për femrat. Nëse shohim arsimin e lartë janë femrat ato që zënë një %je më të lartë rreth 6,8 % krahasuar me 2 % që zënë të burgosurit meshkuj.

Pas vitit 2011 numri i të dënuarve si femra dhe meshkuj ka ardhur në rënie, ndërkohë në vitin 2014 kemi rritje të ndjeshme në numrin e tyre. Kështu për këtë vit numërohen 13.618 persona të dënuar, rreth 59 % më shumë krahasuar me vitin 2013.

Në vitet 2010-2014 shohim që kemi një rritje të ndjeshme të numrit të femrave të dëmtuara nga vepra penale "Dhuna në familje", ndërkohë në vitin 2015 kemi një rënie të numrit të tyre, rreth 11,8 % më pak krahasuar me vitin 2014. Ndërkohë shifra të larta kemi te meshkujt të dëmtuar si pasojë e shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor me 2.416 meshkuj të dëmtuar ndërsa femra (816).

## Juridical statistics

The juridical statistics of this chapter provide an overview of gender disaggregated data on crimes (offenders and victims), convicts and prisoners, according to certain social characteristics. This information was provided by the General Directorate of Police, General Directorate of Prisons and the Ministry of Justice. Data on offenders are based on persons who are suspected of committing criminal acts, and not on judgments or deliberations of competent bodies of justice.

Data on prisoners give us figures for the number of prisoners by gender, level of education, age group, criminal acts for which they are convicted and vocational training courses that they have attended in prison. The data includes inmates and detainees as of December 31st of each year. In 2015 there were 6,128 prisoners, 6,011 males and 117 females. The age groups both for males and females are 30-60 years old, followed by 18-30 years old. In terms of education, the largest numbers of prisoners, both males and females have completed 9th grade education, followed by persons who have completed secondary education. During 2015, individuals with only a 9th grade level of education accounted for the biggest share of the total number of male prisoners, while numbers of males and females with a secondary education were about the same. If we look at higher education, here the percentage is higher for females, at approximately 6.8% compared to 2% for male prisoners.

After 2011, the number of female and male prisoners declined but then in 2014, there was a significant increase in these figures. For this year, the number of convicts was 13,618, an increase of 59% compared to 2013.

In the course of 2010-2014, we notice a significant increase in the number of women victims of domestic violence. However in 2015 there was a drop in the figures of approximately 11.8% compared to 2014. Meanwhile, there are a significant number of male victims, hurt as a result of violation of traffic rules. The figures were 2,416 males and 816 females.

Në Shqipëri numërohen në terma absolute 2.725 femra që denoncojnë dhunën, të cilat përbëjnë rreth 77 % të numrit të përgjithshëm të personave të dhunuar. % më e lartë e femrave që përjetojnë dhunë në familje është e përqëndruar në qarkun e Tiranës me 34,3 % femra të dhunuara, ndjekur më pas nga qarku i Durrësit me 18,3 %, ndërkohë qarku i Kukësit dhe ai i Dibrës shënojnë %jen më të ulët, me 1,2 % femra të dhunuara. Nëse do ta shprehim numrin e femrave të dhunuara në raport me numrin e popullsisë së tyre, norma e femrave të dhunuara, qarku i Durrësit, Beratit dhe Tirana janë qarqet me normën më të lartë të femrave të dhunuara, respektivisht me 36,6, 24,1 dhe 23,1 shprehur për 10 mijë banorë femra. Ndërkohë qarku i Dibrës (5,2), Kukësit (8,2) dhe Shkodrës (9,1) përbëjnë qarqet me normën më të ulët.

Në grupveprën “Krime kundër personit” përfshihen krimet kundër jetës, kundër shëndetit dhe lirisë. Në lidhje me këtë grupvepër kemi të dhëna rreth numrit të krimeve të evidentuara ndër vite dhe numri i personave të dëmtuar sipas gjinisë. Kështu në vitin 2015 numërohen 438 persona të dëmtuar nga krimet kundër personit, 401 janë meshkuj dhe 37 janë femra, rreth 40,4 % më pak të dëmtuar në krahasim me vitin 2009. Ndër vite vihet re që janë meshkujt ata që dominojnë si viktimë të krimeve kundër personit. Nëse do flasim në nivel rajonal, është qarku i Shkodrës me %jen më të lartë të femrave viktimë të krimeve kundër personit, ndjekur më pas nga Korça dhe Vlora. Ndërkohë në qarkun e Dibrës dhe Gjirokastrës nuk kemi asnjë femër viktimë të krimeve kundër personit.

In Albania there are, in absolute terms, 2,725 women victims of domestic violence and that accounts for approximately 77 % of the total. The highest percentage of women victims of domestic violence is in the prefecture of Tirana. The figure is 34.3%, followed by the prefecture of Durrës with 18.3%. The lowest rates are in Kukës and Dibra, at 1.2% women victims. If we are to express the number of women victims vis-a-vis the female population total, the rates of women victims are highest in the prefectures of Durrës, Berat and Tirana, respectively with 36.6, 24.1 and 23.1% per 10 thousand inhabitants. Meanwhile the prefectures of Dibra (5.2), Kukës (8.2) and Shkodra (9.1) represent the prefectures with the lowest rates of women victims of violence.

Crimes against persons include crimes against the life, health and freedom of individuals. For this offense there are figures about crimes in terms of years, and in terms of number of victims, according to gender. Thus, in 2015 there were 438 victims of crimes against persons, 401 males and 37 females, which is approximately 40.4% less than in 2009. For years males dominated as victims of crimes against persons. If we consider the prefecture level, the prefecture of Shkodra has the highest percentage of women victims of crimes against persons, followed by Korça and Vlora. There are no women victims of crimes against persons in the prefectures of Dibra and of Gjirokastra.

**Të burgosur sipas dy ndarjeve kryesore moshore dhe gjinisë**  
Rate of crime, by sex of victim

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
<b>Meshkuj</b>								<b>Men</b>
Të burgosur të rritur	2905	2623	2663	2718	2865	2788	2912	Adult prisoners
Të burgosur të mitur	16	14	18	13	19	9	13	Juvenile prisoners
<b>Femra</b>								<b>Women</b>
Të burgosur të rritur	80	81	59	56	58	41	60	Adult prisoners
Të burgosur të mitur	0	0	0	0	0	0	0	Juvenile prisoners

Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve

Source: General Directorate of Prisons

Shënim: Përfshihen vetëm të dënuarit me burg, jo të paraburgosurit

Note: Are included only prisoners, not detainees

**Të burgosur sipas veprave penale dhe gjinisë**  
Prisoners by penal offences and sex

Vepra penale	2014		2015		Penal offences
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
	Men	Women	Men	Women	
Vjedhje	1485	6	1200	12	Robbery
Vrasje	1318	24	1447	23	Homicide
Plagosje	186	0	218	0	Injury
Marrëdhënie seksuale me dhunë	111	1	134	0	Sexual crime
Krime në fushën e drogës	1127	15	1307	22	Drug crimes
Organizata kriminale	17	0	28	0	Criminal organizations
Mashtrim	65	9	53	15	Fraud
Shfrytëzim prostitucioni	81	12	70	9	Exploitation of prostitution
Të tjera	969	27	1554	36	Other
<b>Gjithsej</b>	<b>5359</b>	<b>94</b>	<b>6011</b>	<b>117</b>	<b>Total</b>

Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve

Source: General Directorate of Prisons

Shënim: Përfshihen të dënuarit me burg dhe të paraburgosur

Note: Are included prisoners and detainees

**Të burgosur sipas grupmoshës dhe gjinisë**

Prisoners by age-group and sex

Grupmosha	2014	2015	Age-group
	Meshkuj-Men		
<b>Gjithsej</b>	<b>5359</b>	<b>6011</b>	<b>Total</b>
14-18	2,0	1,3	14-18
18-30	47,2	43,4	18-30
30-60	47,2	51,7	30-60
60+	3,7	3,6	60+
Të dënuar të mitur	16	14	18
<b>Femra-Women</b>			
<b>Gjithsej</b>	<b>94</b>	<b>117</b>	<b>Total</b>
14-18	0,0	0,0	14-18
18-30	24,5	26,5	18-30
30-60	71,3	71,8	30-60
60+	4,3	1,7	60+

Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve

Source: General Directorate of Prisons

Shënim: Përfshihen të dënuarit me burg dhe të paraburgosur

Note: Are included prisoners and detainees

### Te burgosur sipas nivelit arsimor dhe gjinisë, 2010-2015

Prisoners by level of education and sex, 2010-2015

Grupmosha	Meshkuj-Men						Age-group
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	
<b>Gjithsej</b>	<b>4561</b>	<b>4575</b>	<b>4536</b>	<b>4909</b>	<b>5359</b>	<b>6011</b>	<b>Total</b>
Analfabetë	249	242	231	253	263	425	Illiterate
Arsim 9 vjeçar	3110	3120	3107	3296	3221	3471	Primary
Arsim i mesëm	1111	1114	1096	1252	1761	1997	Secondary
Arsim i lartë	91	99	102	108	114	118	University
Femra-Women							
<b>Gjithsej</b>	<b>96</b>	<b>84</b>	<b>82</b>	<b>89</b>	<b>94</b>	<b>117</b>	<b>Total</b>
Analfabetë	8	6	6	5	5	6	Illiterate
Arsim 9 vjeçar	49	40	39	54	57	65	Primary
Arsim i mesëm	35	31	30	26	28	38	Secondary
Arsim i lartë	4	7	7	4	4	8	University

Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve


Source: General Directorate of Prisons

Shënim: Përfshihen të dënuarit me burg dhe të paraburgosur

Note: Are included prisoners and detainees

### Të burgosurit sipas nivelit arsimor dhe gjinisë, 2015

Prisoners by level of education and sex, 2015



Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve

Source: General Directorate of Prisons

Shënim: % e të burgosurve meshkuj(femra) për çdo nivel arsime ndaj totalit të të burgosurve meshkuj (femra)

Note: %age of male ( female) prisoners of level of education in relation with all men (female) prisoners

### Personeli në burgje, 2010-2015


Prison personnel, 2010-2015

Personeli Personnel	Personeli në burgjet e të rriturve Prison personnel in adult prisons		Personeli në burgjet e të miturve Prison personnel in juvenile prisons	
	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women
	<b>2011</b>	2988	563	55
<b>2012</b>	3084	531	55	15
<b>2013</b>	3084	531	55	15
<b>2014</b>	3039	473	57	15
<b>2015</b>	3059	544	65	11

Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve  
Source: General Directorate of Prisons

### Përqindja e personelit femra në burgjet e të rriturve dhe të të miturve

Percentage of female personnel in adult prisons, and juvenile prisons



## Të burgosur sipas kurseve të formimit profesional në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimit Penal

Prisoners by professional training courses in prison

IEVP (Burgje)	Lloji i kurseve të formimit profesional Professional training courses	Numri i të burgosurve që ndjekin kurset Number of prisoners who attend courses	Prison
IM Kavajë ( Mitur)	Punë me dru, hidraulikë, saldaturë	20	IM Kavajë ( Juvenile)
	Wood work, hydraulics, Saldatura		
Ali Demi (Femra)	Kujdestari fëmijësh, asistencë sociale	35	Ali Demi (Women)
	Child care, social assistance		
Durrës	Anglisht, italisht	20	Durrës
	English, Italian		
Fushë- Krujë	Anglisht, Turizëm familjar	35	Fushë- Krujë
	English, Family Tourism		
Mine Peza	Anglisht, hidraulikë	76	Mine Peza
	English, hydraulics		
Lushnjë	Elektricitist, mekanik	30	Lushnjë
	Electrician, mechanic		
Peqin	Instalues elektrik, hidraulik, kompjuter	39	Peqin
	Electrical installations, plumbing, computer		
Vlorë	Hidraulikë, elektrikistë, berber	52	Vlorë
	Plumbers, electricians, barber		
Fier	Gjuhë e huaj	55	Fier
	Foreign language		
Vaqarr	Guidë Turistike	40	Vaqarr
	Tourist guide		

Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve  
Source: General Directorate of Prisons



**Të dëmtuarit sipas veprave penale dhe gjinisë**

Rate of crime, by sex of victim


<b>Vepra Penale</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>Criminal Acts</b>
								<b>Total</b>
<b>Gjithsej</b>								
Kundër personit	735	514	555	578	550	475	438	Against the person
Kundër pronës	643	671	994	695	623	163	147	Against property
Vepra për qëllime terroriste	12	6	5	9	21	15	1	Acts for the terrorist purposes
Krime në fushën e trafiqeve të paligjshme	300	255	440	457	375	260	116	Crime in the area of illegal trafficking
Dhuna në familje		1998	2181	2526	3020	4121	3542	Domestic violene
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	636	1152	2208	2395	2381	2675	3232	The violation of road traffic rules
								<b>Men</b>
<b>Meshkuj</b>								
Kundër personit	627	488	514	534	505	441	401	Against the person
Kundër pronës	604	612	945	633	551	144	123	Against property
Vepra për qëllime terroriste	12	6	5	9	21	15	1	Acts for the terrorist purposes
Krime në fushën e trafiqeve të paligjshme	227	124	355	350	278	120	32	Crime in the area of illegal trafficking
Dhuna në familje		338	402	490	674	1031	817	Domestic violene
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	536	985	1878	1944	1946	2097	2416	The violation of road traffic rules
								<b>Women</b>
<b>Femra</b>								
Kundër personit	108	26	41	44	45	34	37	Against the person
Kundër pronës	39	59	49	62	72	19	24	Against property
Vepra për qëllime terroriste	0	0	0	0	0	0	0	Acts for the terrorist purposes
Krime në fushën e trafiqeve të paligjshme	73	131	85	107	97	140	84	Crime in the area of illegal trafficking
Dhuna në familje		1660	1779	2036	2346	3090	2725	Domestic violene
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	100	167	330	451	435	578	816	The violation of road traffic rules

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Source: General Directorate of State Police

### Të dëmtuarit sipas veprave penale dhe gjinisë në %, 2015

The damaged persons by crime and sex in %, 2015



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
 Source: General Directorate of State Police

### Krimet e ndodhura sipas veprave kryesore dhe gjinisë së autorit të krimit

Crimes happened by the main actions and the perpetrators sex to crimes

Vepra penale	2009		2011		2013		2014		2015		Victims of murder
	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women	Meshkuj Men	Femra Women	
Vrasje të regjistruara	96	2	152	7	120	3	104	6	82	4	Registered murder
Vrasje të mbetura në tentativë	305	4	264	6	243	1	196	0	188	2	Attempted murder
Krime seksuale	96	1	49	0	89	0	100	1	180	26	Sexual crime
Vjedhje të pasurisë	1615	11	3246	49	3191	63	4619	159	5239	442	Robbery
Mashtrime	277	58	324	55	445	112	797	82	630	122	Fraud
Fallsifikim monedhash	104	2	74	4	47	5	410	79	84	18	Countefeit

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
 Source: General Directorate of State Police

Shënim: Veprat penale janë shkeljet e ligjit për të cilat parashikohet ndekje penale.  
 Note: Penal Offenses are the violations of law for which prosecution is prescribed.

### Të dënuar sipas grupmoshës dhe gjinisë

Convicted persons by age-group and sex


	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
<b>Meshkuj</b>							<b>Men</b>
Të dënuar të rritur	6744	7305	8570	8316	7562	12452	Adult convicted
Të dënuar të mitur	399	640	673	873	677	765	Juvenile convicted
<b>Femra</b>							<b>Women</b>
Të dënuar të rritur	515	549	501	363	335	393	Adult convicted
Të dënuar të mitur	12	16	10	10	3	8	Juvenile convicted

Burimi: Ministria e Drejtësisë

Source: Ministry of Justice

### Të dënuar sipas gjinisë

Convicted persons by sex




Burimi: Ministria e Drejtësisë

Source: Ministry of Justice

### Viktimat nga krimet ndaj personit sipas gjinisë dhe numri i krimeve të evidentuara ndër vite, 2009-2015


Victims of crimes against person by sex and number of recorded offences, 2009-2015



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
Source: General Directorate of State Police

### Femra që denoncojnë dhunën në familje për vitin 2015, në %

Women who experience domestic violence per year 2015, %




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
Source: General Directorate of State Police

Shënim: Grafiku tregon %jen e femrave të dhunuara për çdo qark në raport me totalin e gjithë femrave të dhunuara për një vit të caktuar

Note: Figure illustrate %age of battered women of each prefecture in relation with total of all battered women in a specific year


**Norma e femrave që denoncojnë dhunë në familje shprehur për 10 mijë banorë, 2015**

The rate of women who denounce domestic violence per 10 thousand inhabitants, 2015



**Viktimat e krimeve ndaj personit sipas prefekturave dhe numri i krimeve të evidentuara, 2015**

Victims of crimes against person by prefecture and number of recorded offences, 2015



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit


Source: General Directorate of State Police

Shënim: Krimet kundër personit përfshihen krimet kundër jetës, kundër shëndetit dhe lirisë etj

Note: Crime against person include crime against life, health and liberty ect

## Përqindja e vrasjeve me pasojë vdekjen nga Dhuna në Familje

Percentage of murders where death was a result of Domestic Violence



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Source: General Directorate of State Police



## Popullsia ekonomisht aktive

Sipas të dhënave të Anketës së Forcave të Punës, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për popullsinë e meshkujve të moshës 15-64 vjeç është 73,4 %, ndërsa për popullsinë e femrave është 55,1 % me një rritje prej gati 4 % krahasuar me vitin 2014. Mes meshkujve dhe femrave në pjesëmarrjen aktive në tregun e punës hendeku gjinor ka pësuar një rënie prej 2 % krahasuar me vitin 2014.

## Punësimi

Gjatë vitit 2015 numri i të punësuarëve në grupmoshën 15-64 vjeç shënoi një rritje me gati 3 % krahasuar me 2014 ( 50,5 % ne 52,9%). Shkalla e punësimit si për meshkujt ashtu dhe për femrat është rritur respektivisht me 2,5 % për meshkujt dhe 2 % për femrat.

Struktura e punësimit sipas statusit në punësim tregon se 19,7% e femrave janë të punësuar me pagë krahasuar kjo me 25 % të meshkujve. Përqindja e të vetë-punësuarave femra ka një rritje të lehtë krahasuar me 2014, por sërish është gati tri herë më pak sesa % e meshkujve të vetë-punësuar (përkatesisht 8% për femrat dhe 22,7% për meshkujt). Ndërkohë që femrat si punëtore pa pagesë në biznesin e familjes vazhdon të mos ketë ndryshim dhe të jetë më i lartë sesa meshkujt (përkatesisht 18 % për gratë dhe 13 % për burrat).

Sa i përket punësimit sipas aktiviteteve ekonomike, në vitin 2015 rezultojnë se sektori bujqësor punëson 41,3% e të punësuarave duke pësuar një rënie me 1 % krahasuar me vitin 2014. Rënia e të punësuarave në këtë sektor i atribuohet rënies në numrin e të punësuarave femra në këtë sektor me gati 2 % krahasuar me vitin 2014. Sektori i dytë që zë peshën më të madhe në punësimin e grave pas sektorit të bujqësisë është ai i shërbimeve jo të tregut ku përfshihen aktivitetet si administrimi publik, shërbimet sociale, dhe aktivitete e shërbime të tjera.

Edhe për popullsinë e meshkujve të moshës 15-64 vjeç punësimi mbizotëron në sektorin e bujqësisë, por në një shkallë shumë të ulët sesa për femrat.

## Economically active population

According to data from the Labor Force Survey, in 2015 the participation rate in the labor force for 15- 64 years old males was 73.4%, whereas for the female population it was 55.1%, with an increase of 4% compared to 2014. The gender gap between the participation of men and women in the labor market has narrowed by 2% compared to 2014.

## Employment

During 2015 the number of employees in the 15-64 age group increased by nearly 3% compared to 2014 (50.5 % to 52.9%). The employment rate for both males and females has increased by respectively 2.5% and 2%.

Employment structure as determined by whether someone is in employment shows that 19.7% of females are paid workers, compared to 25% of males. The percentage of self-employed women has risen slightly compared to 2014 but is still almost three times lower than the percentage of self-employed men (8% for women and 22.7% for men). Meanwhile the percentage of unpaid female workers in the family business hasn't changed and remains higher than the figure for male unpaid workers (18% for females and 13% for males).

Regarding employment by economic activity, in 2015 the agriculture sector employed 41.3% of the total workforce, a drop of one percent on 2014. The decrease of the number employed in this sector is attributed to the decline in the number of female workers in this sector by almost 2% compared to 2014. The second biggest sector in terms of numbers of women employed after agriculture is non- market services, which include activities such as: public administration, social services and other activities and services.

When it comes to the employment of males aged 15-64, agriculture is again the main employer but at a much lower rate than for women.



## Papunësia

Në vitin 2015 sipas të dhënave të anketës së forcave të punës shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç është 17,5 %. Shkalla e papunësisë për meshkujt ka pësuar një rënie prej 2,5% krahasuar me 2014 (nga 19,7% në 17,1%). Ndërkohë që situata e papunësisë për femrat është përkeqësuar duke u rritur me 2,0% krahasuar me vitin 2014. Si pasojë në vitin 2015 na rezulton e njëjta normë papunësie si për meshkujt ashtu dhe për femrat.

## Politikat e punësimit

Të dhënat administrative të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ndër vite tregojnë një rritje të ndjeshme të punëkërkuës të papunë të regjistruar në kurse formimi profesional, ku diferencat gjinore janë të ndjeshme. Meshkujt punëkërkuës të papunë të regjistruar në kurse të formimit profesional rezultojnë të jenë gati 30 % më shumë sesa femrat. Ndërkohë që punëkërkuese femra të papuna pjesëmarrëse në programe të nxitjes së punësimit në tre vitet e fundit kanë pësuar një rritje me gati 90 %. Në vitin 2015 femrat punëkërkuese të papuna pjesëmarrëse në programet e nxitjes së punësimit, rezultojnë të jenë gati sa dyfishi i meshkujve.

## Unemployment

